

# FAKTE PER VAKSINEN E COVID-19

Maj, 2021

## Çfare bëjnë vaksinat?

Kur injektohen vaksinat për virusin, trupi i krijon anti-trupat për të luftuar virusin. Pastaj e lufton virusin nëse i ekspozoheni në të ardhmen.



## A është e mundur që vakcina të më jap virusin?

**JO**

Nuk është e mundur që të merret (virusi) Covid-19 nga vakcina.

## Sa kushton vakcina?

Vaksina është **FALAS** për të gjithë.

Mund të ju pyesin që të jepni të dhënat e sigurimit shëndetsor. Kjo ndodh sepse administruesit e vaksinës mund të kompensohen për administrimin e vaksinës (jo koston e saj)

## Si funksionon vakcina?

Vaksinat e Pfizer dhe Moderna funksionojnë njësojë.

- Virusi ka proteina në sipërfaqe të tij.
- Vaksinat mRNA COVID-19 I tregojnë trupit si të prodhojë proteinën e njëjtë për një farë kohe, që trupi juaj të reagojë dhe të krijojë anti-trupat për këtë proteinë.
- Nëse i ekspozoheni virusit, trupi i juaj tanimë e identifikon dhe e sulmon atë proteinë në sipërfaqen e virusit. Në këtë mënyrë e shkatërron virusin.
- Vaksinat COVID-19 NUK futen dhe NUK e ndërrojnë ADN (Acidin Dezoksiribo Nukleik).

## A do të kenë efekt vaksinat kundër varjanteve të reja të virusit?

Ekspertët thonë se sipas të gjitha të dhenave, vaksinat e Pfizer dhe Moderna do të jenë efektive kundër të gjitha formave të koronavirusit / COVID-19 që tani janë në qarkullim. Shkencëtarët dhe prodhuesit e vaksinës vazhdojnë ta vëzhgojnë këtë çështje me kujdes.

## Sa efektive janë vaksinat COVID-19?

**95%**  
**EFEKTIVE**

Vaksinat e Pfizer dhe Moderna janë vakcina mRNA të miratuara në SHBA. Të dyjat janë rreth **95% efektive** në parandalimin e sëmundjes së njerëzve me COVID-19.

## Sa doza të vaksinës më duhen?

### Pfizer/Moderna

**2 Doza**

#### Doza e dyte:

- Duhet të behet 3-6 jave mbasi është bere doza a pare

#### Mbrojta me e forte:

- 2 jave mbasi behet doza e dyte

### J&J

**1 Dozë**

#### Efektet më I lartë mbrojtës:

- Nje muaj

## A është ngutur me zbulimin e kësaj vaccine?

**JO**

Ka mbi 10 vjet që shkencëtarët kanë punuar të përpunojnë teknologjinë e vaksinës. Shkencëtarët, kompanitë dhe qeveritë kanë bashkëpunuar për prodhimin e vaksinës që të parandalojnë infektimin ndaj virusit. Vakcina është testuar mbi mijëra njerëz vullnetarë.

## Efektet anësore të vaksinës



**Efektet anësore priten, por ato janë shenjë që vakcina po funksionon.**

- **Efektet e rëndomta anësore:** dhimbje e lehtë, skuqje dhe e ënjtur në pjesën e dorës ku është injektuar vakcina.
- **Poashtu mund të përjetohet molisje apo lodhje, ethe, dhimbje të kyçeve, dhembje koke, ose ngritje e vogël e temperaturës**
  - Duket që efektet anësore keqësohen pas marrjes së dozës së dytë, dhe zgjasin prej 24 orë deri në disa ditë.
  - Këto efekte anësore janë të pritshme dhe janë shenjë që vakcina po funksionon.

**Efektet e forta anësore janë të rralla.**

Nëse ndodhin, ato zakonisht mund të paraqiten në 15-30 minutat e para pasi të merret vakcina. Një efekt I forte I mundshëm mund të jetë anafilaksa apo vështirësitë me frymëmarrje.

## A duhet që femrat shtatëzëna ta marrin vaksinën?



- Si duket deri tani, virusi shkakton më shumë dëme tek femrat shtatëzëna se sa ato jo shtatëzëna të së njëjtës moshë.
- Tani për tani, vaksina u rekomandohet femrave shtatëzëna ose atyre që ushqejnë me gjinjë.
  - Mendohet që rreziqet janë të vogla ose jo tërësisht të njohura.
  - Ky është një vendim personal. Këshillohuni me personelin shëndetsor.
- Edhe kur ta merrni vaksinën, është me rëndësi që të mbani maskën, lani duart dhe të mbani distancën kur kujdeseni për veten dhe fëmijën tuaj.

**PO**

### A duhet ta marrin vaksinën COVID-19 njerëzit me probleme shëndetësore?

*(P.SH. tensioni i lartë i gjakut, sheqri në gjak, kancer)*

- Vaksina është e sigurtë për njerëzit me probleme shëndetësore.
- Këshillohuni me personelin shëndetësor në lidhje me çdo shqetësim që të keni, para se ta merrni vaksinën.
- Është shumë e rëndësishme që njerëzit me probleme shëndetësore ta marrin vaksinën. Studimet shkencëtare tregojnë që pasojat janë më të rënda për personat me probleme shëndetsore nëse sëmuren për shkak të COVID-19.

**Do të doja që të prisja para se te vaksinohem, që të shoh se ç'po ndodh me të tjerët.**

**Ju lutemi vaksinohuni sa më shpejtë që të jetë në dispozicionin tuaj.** Vaksinat janë testuar në dhjetra mijëra njerëz. Ne kemi siguri të plotë që vaksinat janë të sigurta dhe efektive. Juve nuk po ju kërkohet të merrni pjesë në studim. Studimet janë kryer tanimë.



## Po fëmijët?

### Femijet nën moshën 12 vjeç.

- Femijet 12 vjeç e sipër mund të vaksinohen me vaksinën Pfizer. Për femijet nën moshën 12 vjeç, shpresojmë që rezultatet e efikasitetit të vaksines Pfizer të publikohen nga mesi ose fundi i vitit 2021.

**Unë e kam pas COVID. A duhet të vaksinohem gjithsesi?**



**PO!**

Duhet të prisni deri satë shëroheni tërësisht.

**Po nëse kam histori të reagimeve serioze ndaj vaksinave?**

**?**

Njerëzit që kanë hasur anafilaksi ose reagim negativ ndaj vaksinës apo përbërësve të vaksinës nuk duhet të vaksinohen.

Megjithatë, njerëzit me histori të anafilaksës apo me vështirësi në frymëmarrje ndaj vaksinave, ilaçeve ose ushqimeve të ndryshme, duhet ta marrin vaksinën.

- Vaksinohuni në një klinikë që është e përgatitur të marr masa efektive kundër reaksionit anafilaktik.
- Njerëzit me histori të anafilaksës duhet të këshillohen me punëtorë shëndetësor dhe poashtu ti njoftojnë qendrat e vaksinimeve për historinë e tyre para se ta marrin vaksinën.

Për më shumë informata, vizitoni: [cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/vaccines/index.html](https://cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/vaccines/index.html)  
[mass.gov/covid-19-vaccine](https://mass.gov/covid-19-vaccine)

Grupet: City of Worcester • UMass Medical School • Edward M. Kennedy Community Health Center • Family Health Center of Worcester • St. Vincent Hospital • Fallon Health • Reliant Medical Group